

20110471297

L I G J
PËR SHPALLJEN E QENDER SË VJETER TË QYTETIT TË OHRIT TRASHEGIMI
KULTURORE ME RENDESI TË VECANTE

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni 1

(1) Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit, e cila paraqet teresi monumentale, shpallet trashegimi kulturore me rendesi të vecante, nenkategoria - rendesi e madhe.

(2) Me shpalljen e teresise monumentale "Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit", trashegimi kulturore me rendesi të vecante, mundesohet:

- ruajtja e perhershme e vlerave historike, artistike, arkitektonike, urbanistike, ambientale, etnologjike, shpirtore, sociologjike dhe vlerave tjera shkencore dhe kulturore, si dhe autenticitetit, unikatit, rrallesise, llojllojshmerise, integralitetit, vjetersise dhe cilesive, permbajtjeve dhe funksioneve tjera,

- krijimi i kushteve të volitshme për mbijetese dhe mbajtja e integritetit të të gjitha të dhenave që i bart në vetvete si deshmi,

- perhapja e njohurive për vlerat, rendesine dhe rolin e saj në identifikimin kulturor,

- aftesimi për të sherbyer për kenaqjen e nevojave kulturore, shkencore, edukative, estetike, ekonomike, turistike dhe nevojave tjera të qytetareve dhe

- pengimi i veprimeve, paraqitjeve dhe ndikimeve me të cilat kryhet ose mund të ndodhe demtim ose degradim.

(3) Teresia monumentale "Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit" e krijuar në periudhen nga shek IV para eres së re deri në shek XXI, si trashegimi kulturore me rendesi të vecante, eshte e mire me interes të pergjithshem për Republikën e Maqedonise dhe gezon mbrojtje të vecante në pajtim me kete ligj, Ligjin për mbrojtje të trashegimise kulturore, Ligjin për menaxhim me trashegimine kulturore natyrore dhe boterore të rajonit të Ohrit dhe ligj tjetër.

Neni 2

Teresia monumentale "Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit" (në tekstin e meposhtem: Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit) gjendet në rajonin e komunes së Ohrit dhe perfshin hapësire me koordinatat si vijojne:

- pika më lindore: Y 41,110582°, X 20,806259°,

- pika më jugore: Y 41,109430°, X 20,804770°,

- pika më perendimore: Y 41,114546°, X 20,787277°,

- pika më veriore: U 41,119025°, X 20,790586°;

- pika më e larte (794m lartesi mbidetare): Y 41,115360°, X 20,791330° dhe me siperfaqe të pergjithshme pre 85 ha 08 a 74m².

Neni 3

Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit i ka kufijte si vijojne:

- Lindje: Kufiri lindor fillon në piken "A" e cila eshte në prerjen e rr. "Iluministet maqedonas" dhe bul. "Turisticka", vazhdon në jug neper boshtin e rruges. " Iluministet maqedonas" (PK 17266) deri në prerjen e rruges së njejte me rr. "Partizanska", shkon në lindje neper boshtin e rr. "Partizanska" (PK 17.330) deri në prerjen e rruges me rr. "Jane Sandanski" dhe vazhdon në jug neper boshtin e rr. "Jane Sandanski" (PK 17.331) deri në prerjen me rr. "Bregliqeni Mareshali Tito" dhe bregun e Liqenit të Ohrit,

- Jug: kufiri jugor fillon nga prerja në rr. "Jane Sandanski" me rr. "Bregliqeni Mareshali Tito" dhe shkon në perendim në rr. "Bregliqeni Mareshali Tito" (PK 17.328) dhe shetitorja në bregun e Liqenit të Ohrit, me ç'rast e perfshin limanin (PK 17.350) dhe vazhdon neper bregun e Liqenit të Ohrit deri në bregun nën kishen "Shen. Jovan Bogoslllov - Kaneo",

- Perendim: kufiri perendimor fillon në bregun e liqenit të Ohrit nën kishen "Shen. Jovan Bogoslllov -Kaneo" dhe shkon në veri neper bregun e liqenit deri në derdhjen e lumit Grashnice në Liqenin e Ohrit dhe vazhdon në veri neper boshtin e shtratit të lumit Grashnice deri në prerjen me rr. "Goce Dellcev" dhe

- Veri: kufiri verior fillon në prerjen e shtratit të lumit Grashnice me rr. "Goce Dellcev" dhe shkon në lindje neper boshtin e rr. "Goce Dellcev" (PK 17.270) deri në prerjen e saj me rr. "Abas Emin", e më tej vazhdon në veri neper boshtin e rr. "Abas Emin (PK 17.222) deri në prerjen e saj me bul. "Turisticka" kthehet drejt lindjes neper boshtin e bul. "Turisticka" dhe perfundon në prerjen e rr. "Iluministet maqedonas" dhe bul. "Turisticka" në piken "A".

Neni 4

(1) Qendra e qytetit të vjeter të Ohrit ka një zone kontakti, me siperfaqe të pergjithshme prej 777 ha 06 a 238 m² me kufijte si vijojne:

- në lindje kufiri fillon nga prerja e rr. "Hekurudha" (PK 17.225/1) me rr. "Bunarbe" (rruge transite lindore) PK 7.236 dhe shkon drejt jugut neper rr. "Bunarbe" (PK 7.236) deri në prerjen me kanalin "Studenicishte" (PK 7.220),

- në jug kufiri fillon nga prerja në rr. "Bunarbe" (PK 7236) me kanalin "Studenicishte" dhe shkon drejt perendimit neper boshtin e kanalit "Studenicishte" (PK 7.220) deri në prerjen e bregut të liqenit prej nga vazhdon drejt veriperendimit, duke e ndjekur bregun e liqeni deri në prerjen me kufirin perendimor të PK 17.044 dhe shkon drejt veriut, duke i ndjekur kufijte perendimore të PK 17.044, 17.043, 17.042, 17.041, 16.983, 16.985, 16.986, 16.987, e pret rr. "Jane Sandanski" dhe shkon drejt perendimit, duke i ndjekur kufijte jugore të PK 16.557, 16.556, 16.555, 16.554, 16.551, 16.550, 16.542, 16.521, 16.519, 16.518, 16.489/1, 16.490/1, 16.490/2, 16.494, 16.495, 16.488, 15.616, 15.617, 15.618, 15.620, 15.621, 15.623 deri në prerjen me kufirin perendimor të PK 15.623 prej nga vazhdon drejt veriut, duke e ndjekur kufirin perendimor të PK 15.623, 15.602, 15.599, e pret rr. "Dimitar Vllahov" (PK 17.304), vazhdon drejt veriut duke e ndjekur kufirin perendimor të PK 15.381, 15.382/2, 15.383, 15.355, 15.353/2, e pret rr. "Dame Gruev" (PK 17.290) dhe serish shkon drejt veriut, duke e ndjekur kufirin perendimor të PK 14.471, 14.472, 14.473, 14.478, 14.479, 14.353, 14.352 e pret bul. "Turisticka" prej ku shkon drejt perendimit, duke i ndjekur kufijte jugore të PK 14.345, 14.341, 14.340, 14.339, 14.338, 14.337, 14.335, e pret rr. "Abas Emin" (PK 17.222) prej nga vazhdon drejt jugut, duke i ndjekur kufijte lindore të PK 13.714, 13.717, 13.715, 14.131, 14.132, 14.133, 17.282/1, 14.137, 14.139 prej nga shkon drejt perendimit, duke i ndjekur kufijte jugore të PK 14.139, 14.146, 14.147, 14.148, 14.149/3, 14.149/2, 14.149/1, 14.152, 14.109, 14.108, 14.107, 14.106, 14.105, 14.104, 14.103, 13.102, e pret rr. "Mali i Pirinit" (PK 17.269) dhe vazhdon drejt perendimit, duke i ndjekur kufijte jugore të PK 14.092, 14.091, 14.090, 14.089, e pret rr. "Stiv Naumov" (PK 17.214) prej nga shkon drejt perendimit duke i ndjekur kufijte jugore të PK 14.085, 14.084, 14.083, 14.082, 14.073, 14.072, 14.070, 14.069, 13.788, 13.789, 13.790, 13.794, 13.793, 13.860, 13.862, 13.863, 13.864, 13.865, 13.857, 13.866, 13.867, 13.854, 13.850, 13.849, 17.270, 13.811, 13.812, e pret rr. "Goce Dellcev" (PK 17.270) dhe shkon drejt jugperendimit, duke i ndjekur kufijte lindore të PK 13.833, 17.189, 13.836, 13.874, 13.875, 13.876, 13.877, 13.879, 13.880, 13.881, 13.883, 13.884, 14.011, 14.012 deri në prerjen me bregun e Liqenit të Ohrit prej nga shkon në veriperendim, duke e ndjekur bregun e Liqenit të Ohrit deri në prerjen me rr. "Andon Dukov" (PK 3.274),

- në perendim kufiri fillon nga prerja e bregut të Liqenit të Ohrit me rr. "Andon Dukov" dhe vazhdon drejt verilindjes neper boshtin e rr. "Andon Dukov" (PK 3.274) deri në prerjen me rr. "Zheleznicka" dhe

- në veri kufiri fillon nga prerja e rr. "Andon Dukov" me rr. "Zheleznicka" dhe vazhdon drejt juglindjes neper boshtin e rr. "Zheleznicka" (PK 17.225/1) deri në prerjen me rr. "Bunarbeu".

Neni 5

(1) Kufijte e Qendres së vjeter të qytetit të Ohrit dhe zonave të tij kontaktit sipas neneve 3 dhe 4 të këtij ligji (në tekstin e metejme: rajon i mbrojtur), Agjencia për Kadaster të Patundshmerive i shenon në bazen gjeodezike në perpjesetim 1: 1000.

(2) Organi nga paragrafi (1) i këtij neni për çdo parcele të kadastrës që gjendet në kufijte e rajonit të mbrojtur, në evidencën dhe në dokumentacion e kadastrës e shenon se është pjesë perberese e Qendres së vejtur të qytetit të Ohrit si trashëgimi kulturore me rendesi të vecante, kurse për çdo të mirë të mbrojtur në vecanti në kufijte e rajonit të mbrojtur, se ka status të trashëgimise kulturore me kategori perkatese të percaktuar me aktin për shpalljen e saj.

(3) Kufijte e rajonit të mbrojtur nga paragrafin (1) i këtij neni nuk mund të ndryshohen me plan hapesinor dhe urbanistik as me lloj tjetër akti, përvenc me akt për mbrojtje ose akt për ndryshim në pajtim me dispozitat për mbrojtje të trashëgimise kulturore.

Neni 6

(1) Për mbrojtjen, rregullimin, revitalizimin dhe shfrytëzimin racional të Qendres së vejtur të qytetit të Ohrit, Komuna e Ohrit miraton plan detal urbanistik me perfshirje të planit në kufijte e Qendres së vjeter të qytetit të Ohrit nga neni 3 i këtij ligji.

(2) Për zonën e kontaktit nga neni 4 i këtij ligji, komuna e Ohrit miraton plane detale urbanistike.

(3) Planet nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni perpunohen sipas bazave mbrojtese konservuese të pergatitura nga Institucioni Nacional - Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe Muzeu-Oher.

(4) Bazat e mbrojtura-konservuese për teresine monumentale Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit, detyrimisht permbajne masa të lejuara dhe restriktive për çdo pjesë perberese të vecante në teresine monumentale.

(5) Bazat e lejuara mbrojtese-konservuese nga paragrafet (3) dhe (4) të këtij neni, do të inkorporohen në planet e detajuara urbanistike, si kushte të vecanta për ndertim për secilen parcele ndertimore në vecanti.

Neni 7

(1) Në Qendren e vjeter të qytetit të Ohrit nuk guxon:

1) të ndryshohen struktura ekzistuese urbane dhe dendesia e popullates, kufijte e blloqeve dhe parcelave urbane si pjesë e urbanizmit organik, rrjetit rrugor, vendkalimeve drejt liqenit dhe të gjitha sipërfaqeve të hapura dhe të gjelbra;

2) të ndryshohen lartësia dhe pamja e fasades së të mirave të mbrojtura dhe objekteve ambientale;

3) të ndryshohet gabariti i të mirave të mbrojtura;

4) të ndertohen objekte të reja të cilat si lartësi kanë galeri ose nenkulm, pa ose me baxhe, ose janë të mbuluara me tarrace të rrafshet;

5) Kuota e perdheses të jete më e vogël se 10 cm, as më e madhe se 90 cm mbi nivelin e rruges lidhese respektivisht nga pika "A" nese objekti del së paku në dy rrugë;

6) lartësia e paster e perdheses të jete më e vogël se 2.40 cm as më e madhe se 2.80 cm, perkatesisht se 3.20 cm për kompleksin "Carshia" dhe kompleksin "Cinari";

7) lartësia e paster e kateve të jete më e madhe se 3.00 cm;

- 8) të kryhen pune ndertimore ose pune tjera pa u kryer hulumtime arkeologjike të tokës;
 - 9) të realizohet erker më i madh se 50 cm për kompleksin "Carshia", e për të gjitha objektet tjera të qendres së vjetër të qytetit të Ohrit të realizohet ekrer më i vogël se 50 dhe më i madh se 80 cm dhe të jete në lartësi më të vogël se 3.60 m prej nivelit të rrugës në vendet ku ka komunikacion motorik;
 - 10) të ndertohen garazhe si objekte të vecanta në parcela ndertimore;
 - 11) të rriten gabariti dhe lartësia e objekteve ndihmëse;
 - 12) të futen dedikime të reja që shkaktojnë zhurmë dhe ndotje të rrethines;
 - 13) të parkohet në të mirat e mbrojtura dhe të formohen vendparkime afër tyre;
 - 14) të ndryshohet perpunimi i rrugëve për kembësore dhe rrugëve të komunikacionit me pllaka guri dhe gure kubike graniti;
 - 15) të perdoren paver- elemente (bekaton) si perpunim i sipërfaqeve për kembësore;
 - 16) të vendosen mbajtës, antena televizive, repetitore, pano të mëdha reklamuese dhe ngjashëm dhe
 - 17) të demtohet Qendra e vjetër e qytetit të Ohrit, posacerisht me shfrytëzim joadekuat.
- (2) Në Qendren e vjetër të qytetit të Ohrit regjimi për mbrojtje realizohet sipas parametrave të definuar detal në planet detale urbanistike nga neni 6 i këtij ligji që miratohen për teresinë monumentale, si dhe sipas kushteve të vecanta mbrojtëse konservuese që kanë të bëjë me:
- 1) interpolacionin e kontrolluar të lokacioneve të reja të hapësirave të lira;
 - 2) ruajtjen e të mirave të mbrojtura në gjendje burimore nepermjet konservimit, sanimit dhe në rastë të vecanta me perteritje faksimile;
 - 3) ruajtjen e objekteve ambientale të cilat kontribuojnë për vlerat dhe pamjen ambientale të teresisë në gjendje burimore, në vecanti të pamjes eksteriere të objekteve me konservim dhe sanim, si dhe me perteritjen faksimile të pamjeve karakteristike të fasadave në objektet të cilat kanë demtime të mëdha;
 - 4) kthimin e fondit të humbur të objekteve të lokacioneve që janë të lira dhe për të cilat ekzistojnë plane urbanistike të vjetra, mbetje të objekteve ose dokumentacion teknik dhe fotodokumentacion nepermjet rikonstruksionit, ose perteritjes së tyre tipologjike;
 - 5) kthimin e pamjes së fasadës autentike të atyre objekteve të cilat e kanë humbur, e për të cilat ekzistojnë informata të mjaftueshme për pamjen burimore.
 - 6) rikompozicionin e patundshmerive sipas dedikimit në objekte të reja gjatë rikonstruksionit ose perteritjes tipologjike;
 - 7) mbajtjen e objekteve ambientale në suaza të gabariteve ekzistuese me mundësi për ndertime shtesë më të vogla të lokacioneve personale që nuk do të ndikojnë në mënyrë drastike në ndryshimin e ambientit;
 - 8) mirembajtjen dhe ndertimin e objekteve me kulme në më shumë drejtime me pjerrtësi të vogël (maksimum 22° deri 24°), kurse për objektet që janë në sërë kulme me dy faqe me pjerrtësi të vogël, me përdorim të detyrueshëm të qeramidhës së lakuar si material mbulimi;
 - 9) mbajtjen e fasadës së perdheseve dhe të perdheseve të larta nga guri i thyer, me llaqe në hapjet e përpunuara me tullë, e katet të jenë të suvatuara dhe të zbardhura me gëlqere;
 - 10) mbajtjen e ngjyres autentike të objekteve nga periudha ndërmjet dy luftërave botërore;
 - 11) mbajtjen e ritmit harmonik të vendosjes së dritareve të drurit me thurje të drurit, thurjeve karakteristike prej druri të fasadës, pjerrtesive të drurit dhe kornizat e përpunuara karakteristike;
 - 12) ruajtjen dhe mbajtjen e funksioneve themelore ekzistuese të Qendres së vjetër të qytetit të Ohrit dhe kthimin e disa funksioneve burimore, siç janë zanatet e vjetra ose dhënia e funksioneve të reja bashkëkohore disa objekteve, nëse funksionet e tilla janë kompatible me natyrën e tyre dhe karakterin e teresisë monumentale;
 - 13) vendosjen e të gjitha llojeve të infrastruktures dhe instalimeve të mos jenë të dukshme në hapësirën e qendres së vjetër e qytetit të Ohrit dhe të fasadave rrugore;

14) mbajtjen e asfaltit të rrugeve frekuentuese të komunikacionit motorik që tanime janë të asfaltuara;

15) inkorporimin e mbishkrimeve të firmave dhe mbishkrimeve tjera, billbordeve, reklamave të neonit dhe lloj tjetër reklamash, shenjave të komunikacionit, sinjalizimit monumental, ndricimit, pajisjes urbane të vendeve të hapura dhe

16) marrjen e masave preventive dhe pemiuesuese kunder efekteve destruktive nga zhurma, goditjet dhe vibracionet e shkaktuara nga makinat dhe automjetet.

Neni 8

(1) Në zonen e kontaktit të Qendres së vjetër të qytetit të Ohrit nuk guxon:

1) të kryhen pune tokësore ose pune tjera ndërtimore pa mbikëqyrje arkeologjike;

2) të parashihen ndërtime të reja dhe vija të komunikacionit, si dhe të kryhen pune tokësore dhe punët tjera ndërtimore pa u kryer hulumtime arkeologjike të hapësirave, për të cilat ka njohuri se ekzistojnë lokalitete arkeologjike;

3) të ndryshohet gabariti lartësia dhe pamja e fasades së të mirave të mbrojtura dhe

4) të kryhen intervenime që mund ta rrezikojnë integritetin e të mirave të vecanta të mbrojtura në rreze prej 15 m rreth objekteve.

(2) Në zonen e kontaktit të Qendres së vjetër të qytetit të Ohrit, regjimi për mbrojtje realizohet sipas parametrave të definuar detalisht në planet detale urbanistike nga neni 6 i këtij ligji që miratohen për zonen e kontaktit, si dhe sipas kushteve të vecanta mbrojtëse konservuese që kanë të bëjnë me:

1) ruajtjen e të mirave të mbrojtura në gjendje burimore nepermjet konservimit, sanimit dhe në raste të vecanta me perteritje krahasuese;

2) ruajtjen e kulmeve të më shumë faqeve me përdorimin e qeramidhes së lakuar të mirat e mbrojtura të vecanta;

3) harmonizimin e lartësise dhe gabariteve të objekteve të reja të ndërtuara, në mënyrë me të cilën pamundesohet mbyllja e pamjeve drejt teresise monumentale, vecanerisht në pjesën e zonës së kontaktit që gjendet në rreze prej 500 metrash në vije ajrore nga teresia monumentale me maksimum të lejuar P+4 kate dhe në pjesën e zonës së kontaktit që gjendet në rreze prej 1000 metrash në vije ajrore nga teresia monumentale me maksimum të lejuar P+5 kate dhe

4) përpunimin arkitektonik të objekteve me gabarit të madh në proporcione dhe masa karakteristike.

Neni 9

(1) Komuna e Ohrit dhe organet dhe shërbimet e saj publike janë përgjegjëse për zbatimin e masave dhe aktiviteteve në rajonin e mbrojtur në kuader të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër.

(2) Poseduesit e trashëgimisë kulturore në kuader të rajonit të mbrojtur janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e drejtë të trashëgimisë kulturore në kuader të rajonit të mbrojtur.

(3) Institucioni Nacional-Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kultures dhe Muzeu - Ohër, është përgjegjës për marrjen e masave mbrojtëse konservuese në rajonin e mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 10

(1) Me Qendrën e vjetër të qytetit të Ohrit në emër të Republikës së Maqedonisë menaxhon Institucioni Nacional - Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kultures dhe Muzeu - Ohër, kurse në emër të bashkësisë lokale menaxhon komuna e Ohrit.

(2) Për sigurimin e kushteve të vecanta për ruajtjen e përhershme të teresise monumentale dhe për menjanimin e shkaqeve që i rrezikojnë vlerat e saj, si dhe për realizimin e koordinuar të iniciativave, aksioneve ose projekteve të përbashkëta për mbrojtje, rregullim, shfrytëzim dhe

revitalizim të teresise monumentale "Qendra e vjeter e qytetit të Ohrit", Institucioni Nacional - Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kultures dhe Muzeu - Oher dhe kryetari i komunes së Ohrit, perpilojne Plan për mbrojtje të integruar të Qendres së vjeter të qytetit të Ohrit (në tekstin e metejme: Plan për mbrojtje të integruar).

(3) Planin e miraton Keshilli Drejtues i Institucionit Nacional Enti për mbrojtjen e monumenteve të kultures dhe Muzeu - Oher, me propozim të drejtorit, e me pajtim paraparak të komunes së Ohrit.

(4) Plani për mbrojtje të integruar i permban:

- pasqyren (numri, madhesia, dedikimi i tanishem, valorizimi/revalorizim, dedikimi i ardhshem) e trashegimise kulturore të patundshme në perberjen e teresise monumentale,
- pasqyren dhe vleresimin e gjendjeve me pjese ose ndertime të caktuara në perberjen e teresise monumentale,
- propozimet për sanim, mbrojtje, ndertim dhe ndryshim të dedikimeve të ndertimeve në perberjen e teresise monumentale,
- pasqyren e mjeteve të nevojshme për zbatimin e Planit,
- pasqyren e organizimit dhe dinamikës së realizimit të aktiviteteve në infrastrukturen komunale,
- planifikimin e zhvillimit urban dhe rehabilitimit urban,
- identifikimin e faktoreve dhe rreziqeve potenciale që i rrezikojne vlerat e trashegimise kulturore,
- zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e vetedijes publike për rendesine e trashegimise kulturore,
- percaktimin e drejtimeve për zhvillimin e turizmit kulturor në pajtim me principin e zhvillimit të qendrueshem dhe
- zhvillimin e aktiviteteve për botimin e publikimeve shkencore dhe profesionale, publikimeve me karakter informativ dhe ngjashem.

(5) Plani para miratimit të tij vihet në debat publik.

(6) Plani miratohet për periudhe pesëvjeçare.

Neni 11

(1) Vleresimin dhe mbikeqyrjen e zbatimit të Planit për mbrojtje të integruar, e kryen Keshilli Mbikeqyres i perbere nga nente anetare që i emerone ministri i Kultures, dhe atë prej një perfaqesuesi nga:

- Ministria e Kultures,
- Drejtoria për Mbrojtjen e Trashegimise Kulturore,
- Drejtoria për Mjedis Jetesor,
- Ministria e Transportit dhe Lidhjeve,
- Ministria e Qeverisjes Lokale,
- Institucioni Nacional - Qendra Nationale Konservatore-Shkup,
- Keshilli Nderkombetar për Monumente dhe Vende IKOMOS,
- Komisioni Nacional i UNESCO-s dhe
- Shoqata e Punetoreve Turistike nga Komuna e Ohrit.

(2) Keshilli Mbikeqyres (në tekstin e metejme: Keshilli) ka mandat prej kater vitesh.

(3) Keshilli nga paragrafi (1) i ketij neni një here në viti dorezon ministrit të Kultures, raport për masat e marra për realizimin e Planit.

(4) Në raportin nga paragrafi (3) i ketij neni, jane permbajtur vleresimi për masat e ndermarra dhe rekomandimet për tejkalimin e gjendjeve.

II. MBIKEQYRJA

Neni 12

(1) Mbikeqyrjen e zbatimit të ketij ligji e kryen Ministria e Kultures.

(2) Mbikeqyrjen Inspektuese të zbatimit të ketij ligji e kryen Ministria e Kultures nepermjet inspektoreve të kultures, në pajtim me Ligjin për kulture dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashegimise Kulturore, në pajtim me kete ose me Ligjin për mbrojtjen e trashegimise kulturore.

(3) Në lidhje me zbatimin e dispozites për ndertim dhe planifikim hapesor dhe urbanistik, mbikeqyrje dhe kontroll kryejne organet kompetente për kryerjen e puneve nga sfera e rregullimit hapesor.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

(1) Planet detajore urbanistike nga neni 6 i ketij ligji do të miratohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

(2) Plani për mbrojtjen e integruar nga neni 10 paragrafi (2) i ketij ligji do të miratohet në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

(3) Keshilli nga neni 11 i ketij ligji do të themelohet në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në „Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise“.